

VENDIM
Nr. 85, datë 3.2.2016

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “CMT, SHTUTGART 2017”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”, që do të mbahet nga data 10 deri në 22 janar 2017, si “vend partner”.

2. Në këtë panair Shqipëria përfaqësohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT).

3. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Turizmit për menaxhimin dhe administrimin e projektit “CMT, Shtutgart 2017” dhe të veprimeve financiare.

4. Autorizohet drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit për nënshkrimin e kontratës së pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, në nënshkrimin e kontratës, si “vend partner”, udhëhiqet nga tematika kryesore e panairit të turizmit, sipas çështjeve:

- a) Turizmi bregdetar;
- b) Turizmi i natyrës dhe i aventurës;
- c) Turizmi kulturor dhe historik.

6. Gjatë vitit 2016 paguhet shuma prej 58 400 (pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) eurosh, ku përfshihen pagesat si “vend partner”, për një pjesë të organizimit të *Press Trip* me pjesëmarrjen e gazetarëve të huaj si dhe për një pjesë të aktiviteteve përgatitore që do të organizohen gjatë ditëve të Panairit Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”. Shuma tjetër e organizimit të panairit prej 169 800 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) eurosh do të paguhet gjatë vitit 2017.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekono-mik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama